

Nr. Regj. 18230/12

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Emrush Hetemi nga Prishtina, për kundërvajtje neni 5. 6 paragrafi 1.2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtareve të Lartë Publike dhe Deklarimin dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjitha Personat Zyrtare, e në bazë të nenit 73, 74, 195 dhe konform nenit 198 pika 1 dhe 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 24.08.2012 merr këtë:

AKTVENDIM

PEZULLOHET: Procedura kundërvajtëse ndaj Emrush Rexhep Hetemi, e lindur me 09.03.1954 në Gjakovë, tani jeton në Prishtinë në Rr. Agim Ramdani, Pallati A 1 nr. 99, mjek specialist dermatolog në QKUK Klinika e Dermatologjisë, i martuar baba i tre fëmijëve, fakultetin e kryer, e gjendjes së mesme ekonomike për kundërvajtjen nga neni 5. 6 paragrafi 1.2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtareve të Lartë Publike dhe Deklarimin dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjitha Personat Zyrtare
Procedura Pezullohet konform nenit 198 par. 1 pika 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, për shkak se ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë kundërvajtëse.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur.

Një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet palës dhe parashtruesit të kërkesës.

Arsyetim

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtrori kësaj gjykate kërkesën Nr. 1805/2012 me dt. 18.05.2012 për fillimin e procedurës për kundërvajtje ndaj të pandehurit Emrush Hetemi për kundërvajtjen nga neni 5. 6 paragrafi 1.2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtareve të Lartë Publike dhe Deklarimin dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjitha Personat Zyrtare, me të cilën kërkesë i vihet në barre se në Agjencinë Kundër Korrupsionit nuk e ka deklaruar pasurinë si pas deklarimin e rregullt deri më dt. 31 mars 2012.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit i cila deklaroi se nuk e pranon kundërvajtjen e cila i vihet mbi barre, duke dëshmuar se vetëm për një kohë shkurt e ka ushtruar pozitën si Udhëheqëse Divizionit –Departamenti për Politika Ekonomike në Ministrinë e Financave sipas Ligjit nr. 04/L-050 nuk është obligon për ta deklaruar pasurinë.

Pas administrativit të provave u konstatua se i pandehuri Emrush Hetemi si ushtrues i detyrës nuk ka qenë i obliguar të bëjë deklarimin pasurisë sepse me Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Zyrtareve të Lartë Publike dhe Deklarimin dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjitha Personat Zyrtare nuk është përcaktuar se edhe ushtruesit e detyrës janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë, andaj u konstatua se ndaj të pandehurit nuk ka prova se ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet mbi barre.

Gjykata e Pezulloi procedurën kundërvajtëse ndaj të Emrush Hetemit, konform nenit 198 pika 1 dhe 2 të Ligjit mbi Kundërvajtjet

U VENDOS NE GJYKATEN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr. Regj 14824/12 me dt. 14.08.2012

Gjyqtarja

Lindita Jakupi



REPUBLIKA E KOSOVES		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË		ANEXI	
Dep.	DPK/DMP	Nr. Prot.	03-1785/13
Dep.		Prot.	
Nr. Prot.		Data	10-06-2013
Grup. Instanca	01	Qarku	
Nr. pages		Data	

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund të parashtror Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje të pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës në afat prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi, përmes kësaj Gjykate dhe pa taksë.